

RAPORT NGA HULUMTIMI PËR MUNDËSITË PËR  
INFORMIMIN E NXËNËSVE NGA FUSHA E SHËNDETIT  
RIPRODHUES DHE MBROJTJA E TIJ NË SHKOLLË



## Botim i:

# Asociacioni për edukim shëndetësor dhe hulumtim – HERA

Shkup, gusht 2014

Hulumtimi është zbatuar në bashkëpunim me Qendrën për arsim dhe trajnim profesional

## Autor

### **Mr. Lidushka Vasileska, dr. Speci.**

Këshilltar për arsim dhe trajnim profesional në profesionin shëndetësor

## Ekipi hulumtues:

### **Mr. Lidushka Vasileska, dr. Spec.**

Këshilltar për arsim dhe trajnim profesional në drejtimin shëndetësor

### **Lepa Trpçeska**

Udhëheqëse e Sektorit për zhvillim të standardeve dhe planeve dhe programeve mësimore

### **Spec. Ardiana Isaki Palloshi**

Këshilltare për arsim dhe trajnim profesional në drejtimin kimik-teknologjik

CIP - Katalogizacija vo publikacija  
Nacionalna i univerzitetska biblioteka "Св. Климент Охридски", Скопје

613.88-057.874:37.017(497.7)(043.31)

ВАСИЛЕСКА, Лидушка

Извештај од истражувањето за можностите за информираност на учениците од областа на репродуктивното здравје и неговата заштита во училиштата / [автор Лидушка Василеска]. - Скопје : Х.Е.Р.А. - Асоцијација за здравствена едукација и истражување, 2014. - 48 стр. : табели, граф. прикази ; 30 см

Фусноти кон текстот. - Библиографија: стр. 47

ISBN 978-608-4598-21-3

а) Ученици - Информираниост за репродуктивно здравје - Македонија - Истражувања  
COBISS.MK-ID 97294602

# REZYME PËRFUNDIMTARE



Baza fillestare për këtë hulumtim, nga njëra anë, sipas hulumtimeve dhe vlerësimeve të deritanishme, paraqiste komplikimi i rrezeve, të cilat i ndërmarrin të rinjtë me përgatitje të pamjaftueshme me njohuri dhe shkathtësitë për SHSR dhe avancimin e SHSR të çdo individi, si një nga prioritetet për zhvillim strategjik të vendit dhe veçanërisht, shëndetit të popullatës, nga ana tjetër.

Për këto shkaqe, ajo ndaj së cilës ishte orientuar vëmendja është shqyrtimi i mundësive të cilat i ofron procesi edukativ-arsimor në shkollat për informimin më të mirë të nxënësve për mbrojtjen e shëndetit të tyre riprodhues.

Qëllimi kryesor i hulumtimit ishte të përshkruhen qëndrimet të cilat i kanë nxënësit për mundësitë që i ofron shkolla për marrjen e informatave lidhur me SHSR, si dhe qëndrimet e arsimtarëve të ligjërojnë për temat nga kjo fushë.

Së pari për hulumtimin është bërë analizë e literaturës, e cila i përfshinte fushat me interes të SHSR. Pastaj janë qasjet ndaj hulumtimit të qëndrimeve të nxënësve dhe të arsimtarëve për vëllimin dhe llojin e informatave, si dhe mënyra në të cilën nxënësit i marrin informatat nga fusha e shëndetit seksual dhe riprodhues dhe mbrojtja e tij, por edhe nevojat/sfidat me të cilat ballafaqohet kuadri arsimor gjatë implementimit të këtyre përmbajtjeve.

Për nevojat e hulumtimit, janë përfshirë nxënësit dhe arsimtarët nga shkollat e mesme në nivel të Qytetit të Shkupit, si qytet multi-etnik, në vitin shkollor 2014/2014.

Fokusi është vënë mbi nxënësit të cilët i ndjekin vitet e para në shkollat e mesme, për shkaqet që sipas programeve arsimore, nxënësit kanë qasje deri te informatat për SHSR që nga klasa 7-8, si dhe për shkak të asaj se një nga hulumtimet e fundit, na jep informatë se përvojat e para seksuale të rinjtë nga Maqedonia më shpesh ndodhin mes moshës 14 dhe 15 vjeçare. Është përpiluar ekzemplar i qëllimshëm edhe nga popullata e arsimtarëve, të cilët në shkollë ligjërojnë lëndë mësimore, përmbajtjet e të cilave janë relevante lidhur me shëndetin riprodhues dhe mbrojtjen e tij (biologjia, arsimit qytetar, sociologjia, psikologjia), gjatë së cilës janë përfshirë edhe përfaqësuesit e shërbimeve profesionale në shkolla.

Ekzemplari kishte të bëjë me 330 nxënës dhe 110 arsimtarë nga 22 shkolla të mesme, prej të cilëve 5 gjimnaze, 11 shkolla profesionale dhe 6 shkolla të kombinuara, ose rreth 5% nga popullata e nxënësve e cila hulumtohet dhe më shumë se 5% nga arsimtarët të cilët ligjërojnë në shkollat e mesme.

Prej 330 nxënësve 0 të anketuarve, 255 ose 77% ishin me përkatësi etnike maqedonase dhe 75 ose 22% me përkatësi etnike shqiptare, prej të cilëve 173 ose 52% vajza dhe 157 ose 47% djem.

Prej 110 arsimtarëve të përfshirë në kuadër të hulumtimit, 85 ose 77% ishin me përkatësi etnike maqedonase dhe 25 ose 22% me përkatësi etnike shqiptare, me sqarimin se nuk mund të arrihej barazim me popullatën në pikëpamje të përfshirjes së arsimtarëve sipas përfaqësimit gjinor në kuadër të shkollës. Nga numri i përgjithshëm i arsimtarëve, 58 janë arsimtarë të cilët ligjërojnë lëndë të përgjithshme arsimore, 34 arsimtarë ligjërojnë lëndë profesionale, 11 janë pedagogë, 9 psikologë dhe 2 sociologë, me theks të veçantë se 78 nga të anketuarit janë kujdestarë klase, duke pasur parasysh natyrën e hulumtimit.

Korniza kohore kur u realizua hulumtimi është maj 2014.

Sipas të dhënave të grumbulluara dhe analiza e ofruar në kuadër të hulumtimit, erdhi deri te këto gjetje.

## NXËNËS DHE NXËNËSE

Më shumë se gjysma e të anketuarve (nxënës dhe nxënëse) mendojnë se në arsimin e rregullt përpunohen përmbajtje të cilat kanë të bëjnë me SHSR.

Të pyetur se cilat përmbajtje që kanë të bëjnë me mbrojtjen e SHSR më së shpejti i përpunojnë në shkollë, nxënësit janë përgjigjur: mbrojtja nga HIV/SIDA (75%), (73,64%) pubertet, të drejtat e njeriut (65,45%), mbrojtja nga infektimet seksualisht të transmetueshme (62,42%), organet seksuale me 59,39%, të drejtat e fëmijëve, e përfaqësuar me 56,36%. Për atë se në temat marrëdhënia e parë seksuale (16,06%), marrëdhënie heteroseksuale, homoseksuale dhe biseksuale (11,52%) dhe përdorimi i kontracepsionit oral (11,2%) u përkushtohet vëmendje e vogël, pajtohen edhe nxënësit edhe arsimtarët. Temat grupet e rrezikuara të qytetarëve (11,12%) janë pak të përpunuara, sipas deklaratave të nxënësve, derisa për arsimtarët kjo është tema e organeve seksuale (16,36%).

Sipas të dhënave të fituara, mund të konstatohet se informatat për SHSR dhe mbrojtjen e tij, nxënësit në pjesën në të madhe i marrin në orët e lëndës së biologjisë (81%).

Në lëndën e biologjisë, nga temat të cilat e përfshijnë SHSR, më së shumti punohet në: shumimi i njeriut (88%), karakteristikat seksuale të njeriut dhe organet seksuale (71%), puberteti (66%) dhe mbrojtja nga HIV/SIDA (63%). Nga ane tjetër, në këtë orë më pak vëmendje i kushtohet përdorimit të prezervativit (21%), planifikimi i familjes dhe mbrojtja nga shtatzënia e padëshiruara (21%) dhe përdorimi i kontracepsionit oral (8%).

Më shumë se 82% të nxënësve kanë deklaruar se për SHSR më së shumti kanë mësuar në klasën e tetë.

Më tutje, 39,14% kanë deklaruar se kanë realizuar orë nga arsimi për shkathtësitë jetësore.

Të pyetur për cilat tema kanë diskutuar në orët e kujdestarit të klasës, nxënësit në përqindje më të madhe (50%) kanë theksuar se kjo është tema të drejtat e njeriut, ndërsa pak punohet në: gjinia dhe seksi (13%), përdorimi i prezervativit (12%), grupet e rrezikuara të qytetarëve (11%), planifikimi i familjes dhe mbrojtja nga shtatzënia e padëshiruara (9%), mbrojtja nga keqtrajtimi seksual (9%), organet seksuale (8%), marrëdhënia e parë seksuale (6%), dashuria (3%), marrëdhëniet heteroseksuale, homoseksuale dhe biseksuale (3%), përdorimi i kontracepsionit oral (3%).

Qëndrimet e arsimtarëve janë shumë të ngjashme me deklaratat e nxënësve. Dallimi qëndron vetëm te tema e dashurisë, për të cilën arsimtarët mendojnë se edhe i kushtohet vëmendje më e madhe (35%).

Nxënësit deklarojnë se me temën marrëdhënia e parë seksuale (6%) janë njoftuar shumë pak, ndërsa në të njëjtën kohë 50% shprehin nevojë për informim për atë se kur është më së miri të kenë marrëdhënien e parë seksuale.

Duke pasur parasysh analizën e ofruar, lidhur me dinamikën e realizimit të përmbajtjeve nga SHSR sipas nxënësve, si më e pranueshme në këtë rast duket konstatimi se nxënësit në diskontinuitet i përpunojnë përmbajtjet nga SHSR gjatë mësimin, përkundër arsimtarëve, prej të cilëve 29% pohojnë se temat të cilat kanë të bëjnë me SHSR dhe mbrojtjen e tij përpunohen një herë në muaj, gjatë së cilës, për 42,73% prej tyre, këtyre temave u kushtojnë nga 30 minuta nga ora.

Pothuaj gjysma e të anketuarve janë të kënaqur me mënyrën me të cilën arsimtarët i ligjërojnë temat për SHSR, por si barriera kryesore përmenden mungesa e kohës (43%) dhe orët e rralla në të cilat flitet për këto tema (42%), ndërsa përmendet edhe mënyra e pamjaftueshme e hapur kur flitet për SHSR (36%). Kujdestarët e klasës, sipas 41% të anketuarve, janë ata të cilëve nxënësit dhe nxënëset do t'u drejtoheshin për ndonjë problem.

Nxënësve u nevojiten informata plotësuese për temat që vijojnë: kur është më së miri të kenë marrëdhënien e parë seksuale (50%), lidhja e parë e dashurisë (41%), lidhjet dhe simpatitë (36%), si t'i shmangem kërcënimeve dhe keqtrajtimit në shkollë (32%) dhe ku të kërkoj ndihmë nëse është prishur privatësia ime (30%). Vlen të theksohet, edhe pse në masë të vogël, se të anketuarit dëshirojnë që të dinë edhe rreth asaj se si të mbrohen nga shtatzënia e padëshiruara (27%), si përdoret drejt prezervativi (25%), kur dhe cilit mjek t'i drejtohen (23,33%), ballafaqimi me komentet ofenduese të Fejsbuk (22%). Është interesante se nxënësit kanë deklaruar se informata më së shumti jashtë shkollës marrin nga prindërit (56%). Megjithatë marrja elektronike e informatave lidhur me SHSR – Interneti, renditet mjaft lartë te nxënësit (53%).

Diçka që është mjaft mbresëlënëse përmes gjithë analizës së të dhënave është informimi më i madh dhe interesimi për përmbajtjet nga SHSR nga ana e vajzave, në përgjithësi (nga përkatësia shqiptare dhe maqedonase), në raport me djemtë.

Si përfundim i përgjithshëm imponohet të kuptuarit se nxënësit me përkatësi shqiptare kanë qasje dukshëm të ndryshme ndaj informatave, veçanërisht ndaj disave, të cilat janë mjaft të rëndësishme për shëndetin e tyre. Për shembull, të rinjtë me përkatësi etnike shqiptare kanë deklaruar se në orët e biologjisë aspak nuk janë njoftuar me temat si përdorimi i prezervativit, kontracepsioni oral dhe menstruacioni.

## ARSIMTARËT DHE ARSIMTARËT

Një pjesë e arsimtarëve dhe arsimtareve kanë deklaruar se tema puberteti si temë më e përpunuar në orë (59%), pas saj vijojnë të drejtat e njeriut me 52,73% dhe mbrojtja nga HIV/SIDA (50%). Si tema më pak të përpunuara janë përdorimi i prezervativit (23%) dhe mbrojtja nga keqtrajtimi seksual (21,82%), përdorimi i kontracepsionit oral (16% maqedonas, 4% shqiptarë).

Në orët e biologjisë më së shumti punohet mbi mbrojtjen nga IST dhe HIV/SIDA (18% shqiptarë, 15% maqedonas), ndërsa shumë pak mbi përdorimin e prezervativit (11% maqedonas, 0% shqiptarë) dhe kontracepsioni oral (8% maqedonas, 0% shqiptarë).

E ngjashme është situata edhe me lëndën arsimit për shkathtësi jetësore, më së shumti punohet mbi HIV/SIDA (40% shqiptarë, 35% maqedonas), puberteti (40% shqiptarë, 36% maqedonas), ndërsa pak për përdorimin e prezervativit (15% maqedonas, 8% shqiptarë) dhe kontracepsioni oral (9% maqedonas, 4% shqiptarë).

Arsimtarët janë ndarë sipas dinamikës së realizimit të orëve nga arsimit për shkathtësi jetësore kushtuar SHSR. Kështu, pjesa më e madhe ka deklaruar se shfrytëzohet një orë në muaj për përpunimin e temave nga SHSR (29%), për atë se këto përmbajtje i përpunojnë një herë në javë kanë deklaruar 26%, ndërsa 19% të arsimtarëve janë deklaruar se temat i përpunojnë në 2 orë në muaj.

Shumica e të anketuarve (42%), prej të cilëve 47% të arsimtarëve me përkatësi etnike maqedonase dhe 28% të arsimtarëve me përkatësi etnike shqiptare, kanë deklaruar se kur punojnë në tema nga doracaku për arsim për shkathtësi jetësore, të cilat kanë të bëjnë me SHSR, u përkushtojnë 30 minuta nga koha e orëve të kujdestarit të klasës.

Sipas arsimtarëve, mënyra më e mirë është që përmbajtjet nga SHSR të realizohen përmes lëndës ku nxënësit mund të zgjedhin, për çka janë deklaruar 42% të arsimtarëve, prej të cilëve 49% të arsimtarëve me përkatësi etnike shqiptare dhe 41,18% të arsimtarëve me përkatësi etnike maqedonase. 19% kanë deklaruar që këto përmbajtje të mësohen përmes lëndës së rregullt. Por një numër i caktuar i arsimtarëve (35%) e mbështetin edhe mënyrën e deritanishme të realizimit të temave nga SHSR.

Të pyetur për sfidat me të cilat ballafaqohen duke i realizuar përmbajtjet nga doracaku për arsim për shkathtësi jetësore, 50% kanë deklaruar se nuk kanë kohë të mjaftueshme për përpunimin e këtyre përmbajtjeve.

Për një përqindje të lartë (46%) të arsimtarëve (56% shqiptarë, 43% maqedonas) problem kryesor është mungesa e doracakëve dhe informatat plotësuese. Kjo u vërtetua edhe me përgjigjet në pyetjen pafarë ju nevojitet që ta përmirësojnë mësimin, ku 52% kanë deklaruar se u nevojiten doracakë dhe vegla plotësuese.



**X. E. P. A.**  
Освештавање за здравствено едукацију и истраживање



A Member Association of



European Network

International  
Planned Parenthood  
Federation



Центар за стручно  
образовање и обука